



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/08

Datë: 23.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet të mbledhjeve; 01, 02, dhe 03 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/08

Datë: 23.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) si dhe të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi dhe të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, të datës 15 mars 2020 për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, si dhe pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për aprovimin e kërkesës së Ministrisë së Shëndetësisë

1. Shfuqizohet pika 1.7 e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/07 të datës 11 mars 2020 me të cilin është ndaluar eksporti i pajisjeve, materialeve dhe medikamenteve mjekësore nga ana e operatorëve ekonomik dhe prodhuesve;
2. Shfuqizohet pika 1.2 e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/07 të datës 11 mars 2020 me të cilin është bërë pezullimi i përkohshëm i linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor nga vendet me risk të lartë dhe të mesëm;
3. Shfuqizohet pika 5 e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/09 të datës 13 mars 2020 me të cilin është bërë pezullimi i përkohshëm i të gjitha linjave të udhëtimit ajror në aeroportin e Prishtinës përveç fluturimeve ushtarake, dhe emergjencave medicinale (MEDIVAC). Përjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me ekuipazh por pa udhëtarë që shërbejnë vetëm për largim të udhëtarëve nga Kosova;
4. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/12 i datës 17 mars 2020 me të cilin është bërë plotësim ndryshimi i Vendimit të Qeverisë Nr. 01/09 të datës 13 mars 2020;
5. Shfuqizohet pika 1.5 e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/07 të datës 11 mars 2020 me të cilin aktivitetet publike dhe jopublike kanë mund të zhvillohen të mbyllura pa praninë e publikut si: ngjarjet/tubimet sportive, tubime, konferenca, tryeza të rrumbullakëta;
6. Rifillimi i transportit ajror dhe hapja e ANP "Adem Jashari" në Prishtinë (vetëm vijat e rregullta të domosdoshme që kthehen brenda ditës) me masa të shtuara të sigurisë dhe shëndetit, duke pasur prioritet shëndetin publik dhe parandalimin e përhapjes COVID-19;
7. Obligohet Ministria e Infrastrukturës që të kompletojë Udhëzimet administrative të Agjencionit të Aviacionit, protokollat e operimeve të transportit ajror, bazuar në mënyrë strikte në protokollat e EASA (European Union Aviation Safety Agency), rekomandimet e IKShPK dhe Manualin për mbrojtjen nga COVID-19.

8. Të gjithë udhëtarët që hyjnë në Republikën e Kosovës rekomandohen të kenë testin RT-PCR negativ, jo më të vjetër se 4 ditë;
9. Obligohen institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi;
10. Vendimi hyn në fuqi nga data 28 qershor 2020.

A r s y e t i m

Meqenëse situata epidemiologjike në vend konsiderohet situatë e menaxhueshme, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/08

Datë: 23.06.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me qëllim të ruajtjes së sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe pjesëmarrjes aktive në Aleancat Ndërkombëtare të Luftimit të Grupeve Terroriste.
2. Duke kontribuar në vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si aleat i ngushtë strategjik, Bashkimin Evropian dhe partnerët e tjerë për eliminimin e rreziqeve që i kanosen Republikës së Kosovës dhe partnerëve të saj.
3. Vendos që Organizatën Globale Terroriste "Hezbollah" krahun e saj *politik dhe ushtarak*, ta shpallë si Organizatë terroriste në territorin e Republikës së Kosovës.
4. Obligohen organet përgjegjëse të sigurisë të Republikës së Kosovës që në pajtim me praktikatat ndërkombëtare të ndërmarrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë